

ENRIKETA KAMBO

**FILLIMET E RIORGANIZIMIT TE SISTEMIT ARSIMOR
(1960 – 1963)**

Vitet 60 shënuan futjen e shkollës shqiptare në një periudhë të re, gjatë së cilës u iniciuan një tok ndryshimesh të njohura me emrin “Riorganizimi i sistemit arsimor”. Ato sollën pa dyshim transformimet më me peshë, pas atyre që ajo përjetoi me Reformën Arsimore të vitit 1946. Thelbi i tyre konsistonte në përsosjen e sistemit arsimor ekzistues mbi bazën e parimit të lidhjes të mësimimit me punën në prodhim dhe sidomos, në vendosjen më të mirë të veprimtarisë së shkollës në funksion të kërkesave të partisë-shtet për zhvillimin socialist të ekonomisë dhe të kulturës. *Periudha nga fillimi i vitit 1960 dhe deri në qershorin e vitit 1963, kur edhe përfundoi përgatitja e kuadrit të plotë ligjor, shërbeu si një fazë përgatitore për të kaluar më tej në zbatimin praktik të Reformës.* Analiza e këtij procesi në fillimet e tij përbën edhe objektin e artikullit.

*

* *

Shkolla në fillimin e viteve 60 dhe sfidat e saj

Vitet 60-të sollën zhvillime të rëndësishme në fushën e brendshme dhe atë të jashtme. Brenda kuadrit të ndryshimeve ekonomike dhe politike që kishin ndodhur dhe po ndodhnin në shoqërinë shqiptare arsimit zinte një vend të rëndësishëm. Pa dyshim ai duhej të ndiqte logjikën e zhvillimeve të reja. Por problemi qëndronte në faktin se cili ishte niveli dhe sa ishte i aftë sistemi arsimor të pozicionohej dhe përshtatej me transformimet e pritshme. Gjithnjë e më shumë në këto vite po evidencuhej kontradikta midis pikësynimit të udhëheqjes për zhvillimin socialist të ekonomisë dhe nivelit real të shkollës, të paaftësisë së saj për t’iu përshtatur atij. Dilema qëndronte në faktin se, duhej vazhduar me masa të pjesshme apo më të thella. E gjithë kjo siç dihet, i dha shtysë fillimit të një debati të gjerë në mesin e viteve 50-të, ku u përfshinë organet më të larta partiake, shtetërore dhe një rreth i gjerë specialistësh

të njohur të arsimit. Analiza e nivelit të sistemit arsimor, forcoi mendimin e atëhershëm se, për shkak të një prapambetjeje më të madhe të trashëguar, mundësitë e shkollës shqiptare për tu futur në rrugën e ndryshimeve të thella, në raport me vendet e tjera lindore, ishin më të kufizuara. Një reformë në këto momente do të ishte e parakohshme, do ta sforconte procesin dhe do të hapte probleme të reja. Por në fillimin e viteve 60-të shkolla shqiptare ishte zgjeruar dhe fuqizuar, duke krijuar mundësi më të mira për arsimimin e popullsisë. Nga të dhënat e publikuara, të marra gjithnjë si të mirëqena, rezultonte se numri i shkollave, nxënësve dhe studentëve ishte rritur ndjeshëm. Arsimi fillor ndiqej nga pjesa më e madhe e nxënësve të moshës shkollore, me përjashtime të pakta për fëmijët e zonave shumë të thella malore. Në 557 shkolla 7-vjeçare me 8 569 mësues, mësonin 274 900 nxënës. Shkollat shtatëvjeçare ishin hapur në mjaft qendra rrethesh, si dhe në disa qendra industriale apo fshatra të populluara. Në gjithë vendin funksiononin 69 shkolla të arsimit të mesëm të përgjithshëm me 29 900 nxënës dhe 1 013 mësues dhe 26 shkolla profesionale me 14 100 nxënës dhe 511 mësues. Arsimi i lartë, sidomos pas krijimit të Universitetit të Tiranës, njohu zgjerim nëpërmjet hapjes së fakulteteve të reja. Në 6 shkolla të larta me 288 pedagogë mësonin 6 700 studentë¹.

Ndryshime të rëndësishme kishin ndodhur dhe në veprimtarinë mësimore edukative të shkollës. Duke filluar nga mesi i viteve 50-të, sidomos për kategoritë më të larta arsimore, gjithmonë brenda tipit të shkollës socialiste, ishin hartuar dhe futur në zbatim programe, tekste e metoda të reja. Nëpërmjet tyre u synua sigurimi i një lidhje të ngushtë midis teorisë dhe praktikës dhe futjen graduale të elementëve të arsimit politeknik. Në këto kushte, udhëheqja shqiptare i rikthehet idesë së fillimit të reformës shkollore, duke ngarkuar Ministrinë e Arsimit me përgatitjen e një studimi të plotë mbi gjendjen dhe perspektivën e arsimit. Studimi u diskutua në një konsultë të veçantë nga specialistët si dhe përfaqësues të organizmave partiake dhe shtetërore në 2 shkurt të vitit 1960. Liri Belishova, figurë e rëndësishme politike, sekretare e KQ të PPSH, duke analizuar këtë proces, do të theksonte se “nga ana teorike e

¹ *Anuari statistikor*, viti 1963, f.270-275.

praktike riorganizimi është mjaft i nevojshëm. Kjo vlen edhe për të ngjallur ndjenjën e punës².

Mbi bazën e studimit të përgatitur për këtë qëllim, konstatohet se ishin bërë përparime por, shkolla vazhdon të mbartte mjaft dobësi. Në disa tregues ajo qëndronte prapa vendeve të tjera të rajonit dhe atyre lindore. Kështu, në arsimin fillor për çdo 1 000 banorë në Shqipëri shkonin në shkollë 116 nxënës, në Bullgari 81,5 dhe në Rumani 81,4 kurse në arsimin 7-vjeçar, që përfaqësonte hallkën bazë, treguesit për Shqipërinë ishin më të ulët se Bullgaria por më të larta nga Rumania. Në arsimin e mesëm të përgjithshëm ajo qëndronte prapa gjithë vendeve të tjera të rajonit me 3,7 nxënës për 1 000 banorë, kundrejt 4,5 në Jugosllavi, 13,4 në Itali, 21 në Bullgari dhe 6,3 në Rumani. Për sa i takonte arsimin të lartë, treguesit ishin të barabartë me Rumaninë dhe më të ulët nga gjithë vendet e tjera³.

Në studim zgjerimi i arsimin 7-vjeçar, që përbënte hallkën kryesore në sistemin arsimor, u konsiderua i pamjaftueshëm. Në këtë periudhë ai përfshinte vetëm 70 për qind të nxënësve. Me përjashtim të qytetit të Tiranës, ku tërhiqeshin 100 për qind e nxënësve që përfundonin arsimin fillor, kjo shifër varionte 70-96 për qind për 8 rrethe të vendit, 60-69 për qind për 7 rrethe, 50-59 për qind për 6 rrethe dhe vetëm 20- 45 për qind për pesë rrethe të tjera⁴. Disproporcioni midis fshatit dhe qytetit, rajoneve qendrore apo atyre periferike, mbetet i dukshëm. Numri i nxënësve që i drejtoheshin prodhimit pas përfundimit të arsimin 7-vjeçar, ishte i pamjaftueshëm. Ai duhej të rritej me zhvillimin që parashikohej të merrte ekonomia. Shpejt, si do të theksohej në studim, kërkesat e reja do të nxirrnin nevojën e përgatitjes të një mase gjithnjë e më të madhe të rinjsh që do të mbushnin radhët e punëtorëve të industrisë dhe bujqësisë si dhe të një numri të konsiderueshëm specialistësh të lartë. Me gjithë përpjekjet e bëra, deri në këtë periudhë kishin mundur të përgatiteshin vetëm 20 870 kuadrosh të mesëm, prej të cilëve 9 955 nëpërmjet sistemit të shkollave të rregullta, ose vetëm 47,6 për qind. Kjo nënkuptonte që vetëm një pjesë e specialistëve kishin nivelin e duhur profesional. Veçanërisht mjaft problematik paraqitej niveli profesional. Numri i mësuesve pa arsimin përkatës ishte i konsiderueshëm. Në arsimin fillor vetëm 50 për qind e

² Arkivi Qendror Shtetëror (më tej: AQSh), Fondi 511, viti 1960, dos.2, fl.59-60.

³ Po aty, fl.3-4.

⁴ Po aty, fl.4-5.

tyre ishin të kualifikuar, në arsimin 7-vjeçar 27 për qind dhe në atë të mesmin 65 për qind.

Arsimi i mesëm i përgjithshëm pranohej se kishte ecur me ngadalë se ai profesional. Konstatohet ndërkohë se ritmi i shtimit të nxënësve të rinj në vitet e fundit ishte i pakët. Shkolla e mesme e përgjithshme nuk kishte mundur të plotësonte kërkesat e shkollave të larta për studentë. Në këto kushte vit pas viti ishin marrë nga prodhimi për të ndjekur shkollat e larta një sasi e konsiderueshme kuadrosh të mesme ose maturantë të teknikumeve, duke lënë boshllëqe në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Për të zgjidhur problemin rrjeti i shkollave të arsimit të përgjithshëm, që ishte ende i kufizuar, duhej të ndryshonte dukshëm duke u shtrirë sidomos në rrethe të largëta, në disa qendra të mëdha industriale dhe bujqësore si dhe duke zgjeruar kapacitetin e shkollave ekzistuese.

Arsimi i lartë kishte edhe ai problemet e veta. Numri prej 3045 specialistësh të përgatitur ishte i pamjaftueshëm, kur ekonomisë i nevojiteshin edhe 3950 kuadro të larta. Siç edhe u përmend, deri në këtë periudhë, ai kishte plotësuar 2/3 e nevojave me nxënës të shkollave profesionale, duke krijuar shpërpjesëtime midis specialistëve të lartë dhe atyre të mesëm. Në katër vitet e fundit, ekonomisë i ishin dhënë 1 540 kuadro të larta, që kishin mbaruar studimet brenda dhe jashtë vendit, dhe vetëm 1 600 kuadro të mesme. Në këto kushte lindte nevoja e zgjerimit të arsimit të mesëm, si atij profesional ashtu dhe atij të mesëm të përgjithshëm. Ky i fundit duhej të ishte furnizuesi kryesor i shkollave të larta me studentë.

Mjaft probleme vëreheshin edhe në drejtim të përmbajtjes së procesit mësimor-edukativ. Pranohej se veprimtaria e shkollës linte mangësi, sidomos në përgatitjen praktike të nxënësve. Në këto vite ishin marrë jo pak masa për të zbutur disi shkëputjen e shkollës nga jeta, futjen e elementëve të arsimit politeknik dhe edukimin e të rinjve me dashurinë për punën. Brenda këtij kuadri, në shkollat e arsimit të përgjithshëm ishin bërë ndryshime në planet dhe programet mësimore me pikësynim lehtësimin e tyre nga lënda e tepërt, hapjen e ciklit për disa lëndë që zhvilloheshin dy herë, përmirësimin e raporteve midis shkencave humanitare dhe atyre të natyrës, si dhe shtimin e orëve të ushtrimeve, demonstrimeve dhe punëve praktike. Ishin futur lëndë të reja si: disa njohuri mbi makineritë dhe elektronikën, gjeologjia, gjuha e huaj e dytë në ciklin e lartë të shkollës së mesme, si dhe higjiena dhe ekonomia shtëpiake në shkollën 7-vjeçare. Për të forcuar edukatën e punës, në

shkollat e mesme ishte vendosur puna e dobishme shoqërore, si dhe praktika në prodhim pranë ndërmarrjeve. Masa të tilla ishin marrë gjithashtu në shkollat profesionale dhe në ato të larta. Ndryshimet kishin prekur profilin e disa teknikumeve, gjë që çoi në eliminimin e degëve të specialiteteve të ngushta dhe kalimin përfundimtar drejt politikave të përgatitjes të teknikëve të mesëm me profil të gjerë, si më i përshtatshmi për një ekonomi të centralizuar.

Me gjithë masat e marra, pranohej me gjysmë zëri se në praktikë gjërat nuk ecnin ashtu si duhej. Baza materiale vazhdonte të ishte e dobët. Në klasat e larta të shkollës së mesme, programet e lëndëve të arsimit politeknik mbetën projekte. Ato u zbatuan vetëm në 5 shkolla eksperimentale me drejtim industrial dhe 4 shkolla me drejtim bujqësor. Në disa prej tyre, ku u tregua kujdes për sigurimin e lidhjeve me disa qendra prodhimi në qytete, si: Tirana, Durrësi, Fieri, Shkodra apo Lushnja, u arritën disa rezultate. Por, eksperimenti nuk mundi të shtrihej në masë në të gjitha shkollat e mesme të vendit. Problem i mprehtë, përpos të tjerave, ishte mungesa e mësuesve që zhvillonin lëndët politeknike.

Pavarësisht mangësive e defekteve, studimi e konsideronte momentin të përshtatshëm për fillimin e reformës⁵. Sipas opinionit të shumicës të specialistëve të arsimit, ndryshimet e deri atëhershme dhe rezultatet e tyre, përbënin pikënisjen e zhvillimeve të ardhshme. Zgjerimi më i madh i të gjitha kategorive shkollore, përfshirja në to i masës të të rinjve si dhe perfeksionimi i sistemit arsimor, siç argumentohej dhe në studimin e Ministrisë të Arsimit, do të ishin dy drejtimet kryesore të reformës që do të fillonte të zbatohet në vitin 1963-1964. Ndryshimet e reja, të konceptuara më gjerë dhe më thellë do të preknin strukturën e shkollës, përmbajtjen dhe metodat e mësimit dhe të edukimit. Pikësynimi kryesor do të ishte vendosja e raporteve më të përshtatshme midis arsimit të përgjithshëm, politeknik dhe profesional.

Udhëheqja e vendit, nisur gjithnjë nga pikësynimi i konsolidimit të karakterit socialist të arsimit, ishte mjaft e interesuar për thellimin e këtij procesi nëpërmjet reformimit të sistemit shkollor. Megjithatë, nga analiza e dokumentacionit të kohës vërehet se fillimisht ka një farë stepje të organeve partiake lidhur me afatet e realizimit të reformës. Në analizën që Drejtorja e Arsimit dhe e Kulturës pranë Komitetit Qendror i bënte

⁵ *AQSH*, Fondi 511, viti 1960, dos.2, fl. 52.

studimit të Ministrisë të Arsimit, do të theksohej se “në parim ne jemi dakord me nevojën e riorganizimit, por nuk jemi dakord me afatin e zbatimit”.

Si një problem i madh dhe i vështirë, ku duhej përqendruar vëmendja, trajtohej “forcimi i gjithanshëm i shkollës në vetvete, përmirësimi i cilësisë së mësimi, ngritja e nivelit të njohurive të nxënësve”⁶, duke pohuar se rezultatet ishin të pakënaqshme dhe më të ulëta nga ato të vendeve të tjera socialiste. E një rëndësie të veçantë konsiderohej çështja e sigurimit dhe e kualifikimit të personelit mësimor edukativ. Pjesë e diskutimit u bë edhe problemi i afateve të shkollës së mesme të përgjithshme, në se kjo e fundit do të ishte tre vjeçare apo katër vjeçare. Për rrjedhojë, si prioritete për momentin u konsideruan: zgjerimi i mëtejshëm i rrjetit të shkollave dhe fuqizimi i tyre, futja graduale e arsimit politeknik dhe më tej, marrja e masave përgatitore për riorganizimin e shkollës. Realizimi në praktikë i reformës mund të bëhej duke filluar nga viti 1965-1966⁷.

Duket se udhëheqja më e lartë vazhdonte të ishte në mëdyshje për afatet. Në 23 mars të vitit 1960, çështjet e perspektivës së shkollës analizohen në një mbledhje të veçantë të Byrosë Politike. Enver Hoxha do të shprehej se vërtet duhej ndjekur eksperiencat e të tjerëve, kuptohej ajo e vendeve socialiste,” por në radhë të parë të mbështetemi në kushtet tona konkrete ... Kështu, për shembull, për çështjen e politeknizimit të shkollës, mendoj se ne akoma nuk i kemi kushtet, pasi nuk kemi një industri të zhvilluar” dhe se “te ne nuk ka ardhur akoma koha që nxënësve të shkollës së mesme tu japim një profesion, por qëllimi kryesor i kësaj shkolle të jetë përgatitja e duhur për të vazhduar shkollën e lartë”⁸. Megjithatë pranohet nevoja e reformës. Arsytet e një qëndrimi të tillë në këto momente mund të kenë qenë nga më të ndryshmet. Gjithsesi hezitimet, luhatjet apo opsionet e dhëna, kishin të bënin vetëm me probleme ritmesh, afatesh dhe përcaktim prioritetesh nga duhej filluar.

Shumë shpejt opinioni zyrtar për afatet e fillimit të reformës do të ndryshonte. Duket se një nxitje e fuqishme për këtë ishte fakti se Bashkimi Sovjetik dhe të gjitha vendet e tjera lindore, kishin filluar tashmë reformimin e sistemeve të tyre arsimore. Në pranverën e vitit

⁶ *Po aty*, Fondi 14, viti 1960, dos.2, fl.59-60.

⁷ *Po aty*, Fondi 14 (Fondi i Komitetit Qendror), viti 1960, dos.10, fl.123-126.

⁸ E. Hoxha, *Vepra 18*, Tiranë, 1970, f.137-138.

1960 një delegacion i Ministrisë së Arsimit viziton Bashkimin Sovjetik. Në informacionin e përgatitur për strukturat më të larta partiake, pasi analizoheshin në mënyrë të detajuar drejtimet themelore të riorganizimit të shkollës sovjetike, ritheksohej se kjo ishte e nevojshme dhe e mundshme edhe për shkollën shqiptare. “Në bazë të argumenteve që parashtron Ministria e Arsimit dhe shokët sovjetikë, do të thuhej në këtë informacion, ne jemi dakord që riorganizimi të bëhet duke filluar nga viti shkollor 1963-1964 dhe në themel të riorganizimit të jetë lidhja e të mësuarit me punën prodhuese ... Na duket e drejtë ... që shtyrja e riorganizimit për më vonë do të vononte shumë vënien e shkollës sonë në një rrugë të drejtë zhvillimi”⁹.

Mendohej gjithashtu se me kalimin e kohës do të ishte e vështirë të përfitohej nga eksperiencia e të tjerëve, sidomos duke pasur parasysh zgjidhjen e problemeve të komplikuar si, hartimi i programeve, teksteve sidomos të atyre të shkencave etj. Me sa rezulton nga analiza e dokumenteve të kohës, krahas ndikimit të proceseve të ngjashme në shkollat e tjera të lindjes, një rol të rëndësishëm dhe përcaktues duket se luajti ambicia e udhëheqjes shqiptare, për vënien gjithnjë e më të plotë të sistemit arsimor në funksion të kërkesave të ekonomisë socialiste.

*

* *

Diskutimet për Reformën

Riorganizimi i sistemit arsimor shqiptar u realizua si një procesi i komanduar dhe i kontrolluar nga lart, gradual dhe i përshkallëzuar. platforma mbi ndryshimet në sistemin shkollor u përgatit në formën e tezave siç u quajtën atëherë. në 22 qershor të vitit 1960, Tezat e KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave “Për lidhjen e ngushtë të shkollës me jetën dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të arsimit popullor”, u bënë publike në të gjitha organet e shtypit. Periudha qershor-tetor shërbeu për njohjen e opinionit të gjerë shoqëror me ndryshimet e pritshme. Tezat përvijonin linjat themelore të ndryshimeve të fokusuar në shkollën e arsimit të përgjithshëm që ndahej në dy etapa:

Etapa e parë, afatet e të cilës shtyheshin nga 7 në 8 vjet vazhdonte të përfaqësonte bazën e sistemit të ri arsimor dhe, si e tillë merrte karakter unik dhe të detyrueshëm për të gjithë të rinjtë nga 7 në 15 vjeç. Funkcioni i shkollës 8-vjeçare do të ishte pajisja e nxënësve me një

⁹ AQSH, Fondi 14, viti 1960, dos. 12, fl. 79-93.

kulturë të përgjithshme e politeknike më të plotë dhe sidomos përgatitja psikologjike e praktike e tyre për punë, një orientim më të mirë në zgjedhjen e profesionit të ardhshëm etj. Arsimi politeknik do të sigurohej nëpërmjet mësimit të thelluar të bazave të shkencave dhe mësimit të punës, që do të realizohej në punishte dhe në parcela bujqësore pranë shkollave.

Etapat e dytë, me një kohëzgjatje të diskutueshme 3 ose 4-vjeçare, do t'u jepte të rinjve arsimin e mesëm të plotë nëpërmjet tre rrugëve: *së pari*, nëpërmjet shkollave të mesme të përgjithshme e politeknike, me mësimin e prodhimit; *së dyti*, nëpërmjet shkollave të mesme të përgjithshme të mbrëmjes, me turne, sezonale dhe me korrespondencë; *së fundi*, në shkollat e natës dhe me korrespondencë. Thelbi i shkollës së mesme të riorganizuar qëndronte në plotësimin e njohurive mbi shkencat, zgjerimin e njohurive politeknike të nxënësve dhe marrja e një profesioni nëpërmjet mësimit dhe punës në prodhim. Sipas specifikës të rajonit ku funksiononte shkolla, nxënësit do të punonin pranë ndërmarrjeve industriale, bujqësore, SMT, në sektorët e shërbimit social, duke marrë një ose më shumë specialitete. Pas përfundimit të etapës së dytë të shkollës së mesme, të rinjtë fitonin të drejtën e vijimit të arsimit të lartë ose për të punuar në një nga profesionet e marra.

Në teza evidencohet kërkesa e rritjes së nivelit të dhënies së mësimit të shkencave, si: matematika, fizika, kimia, biologjia, punëve praktike dhe atyre laboratorike. Përparësi do vijonin të kishin lëndët humanitare dhe, në mënyrë të veçantë lëndët e mirëfillta politike, të cilat zgjeroheshin duke i shërbyer më mirë formimit të "botëkuptimit komunist". Përmirësimet do të preknin edhe fushën e metodave të mësimit e edukimit nëpërmjet, rritjes së efikasitetit të orës së mësimit, konkretizimit të tij, shmangies të verbalizimit, nxitjes së punës të pavarur dhe të iniciativës e vetëveprimit të nxënësve. Në veprimtarinë edukative brenda dhe jashtë shkollës më tepër vëmendje do t'i kushtohej formave të ndryshme si: rretheve mësimore, teknike, artistike e sportive për zhvillimin e aftësive individuale, bashkërendimit më efikas të punës së shkollës me familjen dhe organizatat rinore etj.

Riorganizimi i shkollës konceptohej si një proces i gjerë që do të rrokte të gjitha hallkat arsimore. Ndryshime jo të pakta do të pësonte arsimi profesional. Shkollat e rezervave të punës zëvendësoheshin me shkollat e ulëta teknike profesionale, në qytet me afate 1-2-3 vjeçare dhe në fshat 1-2 vjeçare. Vëllimi i kulturës së përgjithshme rritej, por ato nuk

jepnin arsimin e mesëm të plotë. Të rinjtë mund të plotësonin studimet e tyre nëpërmjet sistemit të arsimit të mbrëmjes dhe me korrespondencë. Përgatitja e teknikëve të mesëm do vijonte të realizohej nëpërmjet shkollave të mesme profesionale 4-vjeçare, të ngritura mbi 8-vjeçaren. E reja e tyre konsistonte në atë që, krahas specialitetit do t'u jepnin nxënësve një nivel njohurish të kulturës së përgjithshme të barazvlefshëm me atë të shkollës së mesme. Përgatitja teorike e praktike synohej të forcohej duke arritur që nëpërmjet praktikave mësimore dhe punës në prodhim, nxënësit të aftësoheshin të kryenin proceset kryesore të prodhimit në degët për të cilat studionin.

Zhvillime të rëndësishme i rezervoheshin edhe arsimit të lartë. Në teza këmbëngulej për thellimin e procesit të ndryshimeve të filluara që nga viti 1958 për të lidhur organikisht procesin mësimor me prodhimin. Format konkrete të kësaj lidhjeje kushtëzoheshin nga profili i çdo fakulteti duke synuar që, specialistët e lartë të zotëronin njohuritë përkatëse të shkencës e teknikës, të njihnin teknologjinë dhe organizimin e prodhimit, të përgatiteshin për veprimtari të pavarur drejtuese etj. Përparësi do të merrte përgatitja teorike e praktike e specialistëve të shkencave të natyrës, matematikës, fizikës, kimisë e biologjisë. Pjesë e procesit do të ishte përmirësimi i punës në institutet pedagogjike dhe fakultetet e Universitetit që përgatisnin mësues. “Për pranimin në shkollat e larta, gjithnjë sipas tezave, do të preferoheshin gjithnjë e më shumë të rinj e të reja që vinin nga prodhimi”. Shkollat e larta duhej të bashkërendonin më mirë krijimtarinë shkencore me kërkesat e problemet e ndërtimit socialist. I pa ndryshuar mbetej synimi i njohjes së thellë të bazave të teorisë marksiste-leniniste nga specialistët e lartë të të gjitha sektorëve. Jashtë vëmendjes nuk lihej edhe sistemi i arsimit pa shkëputje nga puna, i cili ishte dhe do të bëhej “një formë e rëndësishme e rritjes së nivelit arsimor të masave dhe përgatitjes së kuadrit për sektorët e ndryshëm të ekonomisë e të kulturës së vendit”¹⁰.

Me publikimin e tezave fillon edhe faza e diskutimit ku u përfshinë një rreth i gjerë pjesëmarrësish. Siç ndodhte rëndom, nën “kujdesin” e organeve partiake, u bënë të gjitha përpjekjet për t'i dhënë ngjyrimet e një diskutimi të gjerë, për të cilin ishin të interesuar të gjitha shtresat e popullsisë. Që në majin e vitit 1960, Drejtoria e Arsimit e Kulturës pranë KQ të PPSH, me anën e një udhëzimi të veçantë, do të kërkonte nga

¹⁰ “Arsimi Popullor”, viti 1960, nr.6, fl.2-9.

Komitetet e Partisë të rretheve marrjen e masave organizative për krijimin e komisioneve për këtë qëllim, dhe në mënyrë të veçantë dërgimin e njerëzve të mirinformuar mbi tezat, që të ishin në gjendje të jepnin sqarime e sidomos, të orientonin “drejt diskutimet”. Komisionet, - do të theksohej në të, - duhet të mbanin shënime të hollësishme “sa veta morën pjesë në diskutime, sa e aprovuan riorganizimin, sa ishte numri i atyre që eventualisht mund të kundërshtojnë” etj.¹¹

Në muajt korrik-gusht 1960, organet e shtypit ndërmorën një fushatë të gjerë propagandistike. Duke zbërthyer drejtimet themelore të reformës së re, theksi vihej në rëndësinë e madhe që ajo kishte për zhvillimin socialist të ekonomisë e të kulturës. Konferenca të shumta u organizuan në shumicën e qyteteve të vendit me pjesëmarrjen e drejtuesve të rëndësishëm partiakë e shtetërorë, specialistë të arsimit, drejtues të shkollave e të kabineteve metodike, mësues e prindër, përfaqësues të shtypit etj. Diskutimi u organizua në dy faza dhe, sipas të dhënave të kohës, në të u përfshinë afro 95 000 njerëz. Fillimisht u veprua në drejtim të njohjes me “tezat”, ku kujdesi më i madh i organeve partiake ishte paraqitja e tij si një diskutim mbarëkombëtar, pavarësisht se sa kuptohej reforma dhe rëndësia e saj. Manush Myftiu, ministri i atëhershëm i Arsimit, do të pranonte se, deri në këtë periudhë shkolla jepte “një edukim të njëanshëm, kryesisht edukim mendor, dhe nuk jep përgatitje për punë. Për këtë është e nevojshme të bëhet riorganizimi i saj ... Një përgatitje të tillë mund ta bëjë vetëm shkolla e bazuar në parimin marksist-leninist të bashkëpunimit të mësimit me punën”¹². Ekonomia socialiste do të kërkonte më shumë specialistë të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të saj. Duke parashtruar qëndrimin zyrtar, do të definonte si qëllimin kryesor të Reformës ndërtimin e “një sistemi të ri arsimor që lidhej më mirë me interesat e masave ... Për zgjidhjen e kësaj detyre të rëndësishme, do të theksonte ai, ne duhet të nisemi jo vetëm nga nevoja e sotme, por të udhëhiqemi nga perspektiva e zhvillimit të vendit tonë”¹³.

Në mbledhje të gjëra të organizuara në disa qytete të rëndësishme, si: Tirana, Korça, Gjirokastra dhe Shkodra apo në ato të katedrave të Universitetit, pjesëmarrësit mbështetën nevojën e ndryshimeve. Intelektualë, prindër dhe të rinj, realisht ishin të interesuar për të rritur

¹¹ *AQSh*, Fondi 511, viti 1960, dos.93, fl.243.

¹² “Arsimi Popullor”, viti 1960, art. M. Myftiu “Mbi riorganizimin e sistemit të arsimit”, nr. 7, fl. 3-7.

¹³ *Po aty*.

shkallën e përfitimit nga sistemi shkollor. Ishte kjo një nxitje e fuqishme për t'u bërë pjesë e procesit, duke kontribuar jo pak në ecurinë e tij. Krahas diskutimeve stereotipe, ku rëndom evidencohet "roli i pa zëvendësueshëm i partisë në fillimin dhe drejtimin e reformës", jo rrallëherë, nga intelektualë të ndryshëm u sollën argumente dhe ide mjaft interesante. Specialistë dhe njohës të mirë të kësaj fushe, diskutuan dhe ofruan mendim të kualifikuar, në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për probleme të mprehta, si ai i sigurimit dhe i kualifikimit të kuadrit të mjaftueshëm dhe të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të reja, hartimit të programeve dhe teksteve, pasurimit të bazës materiale didaktike, të sigurimit të mekanizmave të duhur për bashkërendimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve industriale dhe bujqësore me shkollën etj.

Gjithnjë e më tepër në organet e shtypit, sidomos atij të specializuar, rriten hapësirat për shfaqjen e opinioneve nga intelektualë të fushave të ndryshme, mësues dhe prindër. Revista "Arsimi popullor" organizoi një rubrikë të veçantë ku u botuan shkrime të shumta, si: "A është luks për ekonominë zgjatja e afatit shkollor një vit", "Me tre apo katër vjet", "Cila është ngarkesa reale e planeve dhe e programeve dhe sa ndikojnë ato në përgatitjen e nxënësit", "Pse edhe për disa vite lëndëve si gjuha dhe aritmetika do t'u jepen më tepër orë", "Kush quhet specialitet masiv" etj. Në këto artikuj ngriheshin shqetësime dhe shtroheshin pyetje që kërkonin përgjigje. Por opsionet e dhëna gjithsesi mbetën brenda linjave që konturonin tezat¹⁴.

Shumica e opinionit ndante të njëjtin mendim për sa i takon kalimit nga shkolla 7-vjeçare në atë 8-vjeçare dhe, konsolidimin e saj si kategoria bazë arsimore. Në kuadrin e diskutimeve u rihodh përsëri ideja e fillimit të shkollës fillore në moshën 6-vjeçare, por ajo nuk gjeti miratimin e organeve shtetërore.

Për rrjedhojë, deri në vitin 1965 kur u kalua në sistemin shkollor 12-vjeçar, klasa e parë fillohej në moshën 7-vjeçare¹⁵.

Një nga çështjet e trajtuara edhe më parë, por që tashmë merr një dimension të ri ishte ajo e afateve të shkollës së mesme të përgjithshme. Për të u parashtruan argumente e kundër argumente të ndryshme. Opinioni u nda në dy pjesë, duke shpenzuar energji të shumta. Përqendrimi i vëmendjes më tepër se ç'duhej e shndërroi atë në

¹⁴ Po aty, fl.23-47.

¹⁵ AQSH, Fondi 14, viti 1960, dos. 93, fl. 73.

problemin kryesor, gjë që natyrisht e kufizoi deri diku këndvështrimin për çështje të tjera të reformës. Herë-herë u vërejtën moskuptime dhe paqartësi. Identifikoheshin, siç do të thuhej në një informacion të komisionit për diskutimin e tezave, dy probleme të ndryshme. “A është më mirë me 11 apo 12 vjet me çështjen “A mund të zbatohen për 11 vjet kërkesat e shkollës së re, duke pasur parasysh që të përmirësohet përgatitja e përgjithshme e nxënësve në krahasim me atë të shkollës së sotme”. Probleme shumë të rëndësishme, do të vijonte në të, si ato “që u dalin ndërmarrjeve industriale dhe ndërmarrjeve të tjera për krijimin e vendit të punës për nxënësit, çështjet e përgatitjes dhe të kualifikimit të kuadrit, çështjet e bazës materiale dhe të patronazhit, çështjet e kujdesit më të madh të prindërve dhe të organizatave të masave për edukimin e brezit të ri, çështjet e luftës kundër formalizmit dhe metodave që ndrydhnin iniciativën e mësuesve, çështjet e drejtimit të shkollave ... rrallë dhe përciptas diskutohen nga arsimitarët dhe punonjësit”¹⁶.

Për shumicën e mësuesve duket se ishte më i përshtatshëm varianti i shkollës 12-vjeçare. Drejtuesit e ndërmarrjeve i përmbahen variantit 11 vjeçar. Pjesa më e madhe e prindërve nuk janë të vendosur në zgjedhjen e tyre. Organet partiake dhe komisioni qendror i tezave duket se parapëlqen afatin 12-vjeçar. Drejtuesit e Ministrisë së Arsimit, siç do të thuhej në relacionin përfundimtar mbi rezultatet e diskutimit, dërguar Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës pranë KQ të PPSH, sjellin argumente për të dy variantet, por duket se i tërheq më tepër opsioni i shkollës 11-vjeçare. Por për të vendosur për afatet, sipas mendimit të kësaj të fundit, “duhej para së gjithash të përcaktoheshin faktorët nga duhej nisur, nga leverdia ekonomike dhe sigurimi i kuadrit me ritme të shpejta e për rrjedhojë me cilësi më të dobët ... apo nga pikëpamja pedagogjike, për përgatitjen më të thelluar të nxënësve”¹⁷.

Për përkrahësit e shkollës 11-vjeçare ajo plotësonte kërkesat e reformës, pa ulur nivelin e kulturës së përgjithshme dhe rritur ngarkesën. Gjithnjë sipas tyre, në kushtet e vendit tonë nuk ishte e nevojshme shtimi me një vit i afateve, pasi shkolla jonë kishte “rezerva të pa shfrytëzuara” dhe se shtimi i orëve të punës praktike mund të bëhej duke hequr lëndën e psikologjisë, gjeologjisë apo bërë fakultative gjuhën e dytë të huaj etj. Nga pikëpamja ekonomike ky variant kishte avantazhe. Por nga ana

¹⁶ *Po aty*, Fondi 511, viti 1960, fl. 38-39.

¹⁷ *Po aty*, Fondi 14, viti 1960, dos.93, fl.266.

pedagogjike do të sillte vështirësi, duke çuar në një përgatitje të përcipte e më sipërfaqësore teorike-shkencore të nxënësve.

Varianti 12-vjeçar, duke pasur parasysh faktorë të tillë, si: niveli i përgjithshëm i punës mësimore-edukative, përparimi i dobët i nxënësve në mësim, dobësia e kuadrit, mangësitë në bazën materiale e didaktike të shkollave, interesimi i pakët i familjes, roli i ambientit shoqëror në këtë çështje, ishte më premtues. Për më tepër nga pikëpamja pedagogjike, ky variant realizonte vijimësi më të mirë të procesit mësimor nga një kategori në tjetrën, asimilimin më të plotë të programit dhe forcimin e punës së pavarur. Njëherazi shtonte mundësitë për të lehtësuar etapën e parë tetëvjeçare dhe shpërndarjen më uniforme të lëndës në të dy etapat.

Ndërkohë, rritja e ngarkesës së lëndës për shkak të futjes së mësimit të punës dhe të veprimtarisë në prodhim përbënte një problem të mprehtë me të cilin ishin përballur të gjitha vendet e lindjes që kishin kryer reforma në arsim. Referuar eksperiencës së këtyre të fundit, në Bashkimin Sovjetik shkolla e mesme pas riorganizimit ndryshoi afatet nga 10 në 11 vjet, në Çekosllovakia u kalua nga sistemi 11-vjeçar në atë 12-vjeçar më dy etapa 9 dhe 3-vjeçar, në Republikën Demokratike Gjermane si shkollë bazë ishte 10-vjeçarja dhe e mesmja e plotë 12-vjeçare, për të ardhur tek ajo Bullgare me shkollën bazë 8-vjeçare dhe të mesmen e plotë 12-vjeçare. Pavarësisht specifikës të secilit vend, që të gjitha e kishin shtuar një vit afatin e arsimit të mesëm të përgjithshëm. Parë edhe nga ky këndvështrim, shkolla e mesme 12-vjeçare kishte më tepër shanse.

Problemi i afateve 3 apo 4-vjeçare të shkollës së mesme vazhdoi të konsiderohej një çështje e diskutueshme. Si në tezat ashtu edhe në vetë ligjin e mëvonshëm të riorganizimit, ai mbeti një problem i hapur deri në vitin 1965. Përqendrimi i vëmendjes në diskutimin e afateve, me gjithë rëndësinë që ato kishin, jo rrallë e zhvendosi vëmendjen nga thelbi i gjërave, që konsistonte në faktin se si sistemi i ri shkollor do të arrinte të përmirësonte përgatitjen e përgjithshme teorike e praktike të të rinjve. Megjithatë, pavarësisht nga kufizimet apo njëanshmëria e trajtimit të tyre, mendimet e shfaqura dëshmonin për atë që, mësues dhe njerëz të thjeshtë apo personalitete e figura të njohura të arsimit, ishin të interesuar për krijimin e një sistemi arsimor më fleksibël e të përshtatshëm për individin dhe shoqërinë.

*

* *

Masat që mundësuan fillimin e Reformës

Pas një diskutimi disa mujor, më 8 tetor 1960 u zhvillua një Plenum i veçantë i Komitetit Qendror të PPSH, i cili analizoi gjendjen e shkollës dhe vendosi kthimin e tezave, në platformën bazë për “Riorganizimin e sistemit arsimor”. *Këtu përfundon edhe faza e njohjes me drejtimet kryesore të reformës për të kaluar në atë të përgatitjes të kushteve për fillimin e saj.* Plenumi rikonfirmoi edhe një herë që “Shkolla e arsimit të përgjithshëm të jetë shkollë e mesme e plotë e arsimit të përgjithshëm, politeknike, e punës, me mësimin e prodhimit”. Etapa e saj e parë do të ishte shkolla 8-vjeçare, kurse për etapën e dytë do të vendosej më vonë, pas diskutimit të projektplanit mësimor dhe projekt-programit të lëndëve të veçanta, si dhe të rezultateve të shkollave eksperimentale. Riorganizimi i shkollës do të realizohej në mënyrë graduale në vitet shkollore 1963-1964 dhe 1964-1965, njëkohësisht nga klasa e parë deri në të pestën dhe më tej, duke u shtrirë nga viti në vit. Ndërkohë, strukturat përkatëse ngarkoheshin me detyrën e përgatitjes të kuadrit të plotë ligjor¹⁸.

Kongresi IV i PPSH, në shkurtin e vitit 1961, do të theksonte nevojën e ndërmarrjes së masave të shpejta që do të mundësonin fillimin e procesit. Gjithmonë sipas tij, riorganizimi i shkollës do të vendoste para së gjithash lidhje më të ngushta të saj me prodhimin, forcimin e edukimit komunist, ngritjen e nivelit cilësor e përparimin më të mirë të nxënësve, zgjerimin e rrjetit shkollor të të gjitha kategorive dhe në mënyrë të veçantë, dhe kalimin gradual nga arsimit të përgjithshëm i detyrueshëm shtatëvjeçar në atë tetëvjeçar. Për një periudhë trevjeçare u ndërmorën nga shteti masa të rëndësishme. Fillimisht u punua në fushën e përgatitjes të dokumentacionit të ri shkollor, gjithnjë brenda linjave që përvijuan tezat dhe vendimi për “Riorganizimin e sistemit arsimor”. Specialistë dhe njohës të problemeve të shkollës u angazhuan në hartimin dhe diskutimin e projektplanit dhe më tej të projekt-programeve dhe teksteve të shkollës tetëvjeçare. Ndihmë të veçantë dhanë organet e shtypit, sidomos atij të specializuar, ku u botua një literaturë e gjerë ndihmëse dhe artikuj të mësuesve e metodistëve që sillnin mendimin dhe përvojën e tyre.

Projektplanet e reja parashikonin zhvillimin e përgjithshëm të po atyre lëndëve që trajtoheshin në shkollën shtatëvjeçare, por me ndryshime

¹⁸ PPSH, *Dokumente kryesore*, Tiranë, viti 1970, vëll.III, fl.411-412.

të rëndësishme si në shtrirje ashtu edhe në përmbajtje. Rritja e sasisë së përgjithshme nga 6 724 në 8 611 orë mësimore nëpërmjet shtimit të një viti shkollor lehtësonte dukshëm ngarkesën javore të nxënësve. Kjo krijonte ndërkohë hapësirat e nevojshme për një lidhje më organike midis lëndëve, pasurimin me njohuri të reja dhe ç`ka ishte më thelbësore, përgatitjen e përgjithshme të tyre në nivele më të larta nga ato që ofronte shkolla shtatëvjeçare. Temat mësimore renditeshin në mënyrë më racionale duke iu përshtatur më mirë fuqisë mendore të nxënësve nëpërmjet zhvendosjes së mjaft prej tyre, heqjes së përsëritjeve dhe informacionit të panevojshëm, gjithnjë pa cenuar logjikën e brendshme dhe nivelin e secilës¹⁹.

Elementët e rinj të projekt-programeve u jepnin një pjese të mirë të lëndëve karakter relativisht të plotë dhe të përfunduar si në Histori, Biologji, Gjeometri, Kimi etj. Ajo që e dallonte në parim shkollën tetëvjeçare ishte se, si nëpërmjet mësimit të shkencave humanitare ashtu edhe të atyre natyrore e matematike, nxënësit përfitonin njohuri më të plota teorike dhe aftësi e shprehuri praktike, nëpërmjet parashikimit të më shumë orëve për punimin e drurit e të metaleve, punëve bujqësore, vrojttimeve, eksperimenteve dhe ekskursioneve në natyrë etj. Duke pasur parasysh specifikën e vendndodhjes së shkollës, programet e punës së dobishme shoqërore ishin të ndryshme për shkollat e fshatit nga ato të qytetit.

Për sa i takonte dokumentacionit të ri për shkollën e mesme të përgjithshme u përgatitën dy variante që iu nënshtruan diskutimit të gjerë të mësuesve dhe specialistëve. Megjithatë, ndonëse ndryshonin nga kohëzgjatja, parimet themelore të ndërtimit mbeteshin të njëjta. Nëpërmjet tyre synohej para së gjithash, ngritja e nivelit të përgjithshëm dhe politeknik të njohurive që nxënësit përftonin në raport me ato që ofronte shkolla ekzistuese, një ngarkesë mësimore të pranueshme dhe sidomos përgatitjen në një profesion të caktuar. Nga 15 581 orë mësimore, varianti trevjeçar përmbante 12 679 dhe ai katërvjeçar 13 229 orë. Ngarkesa javore varioje nga 32-34 orë për të parin në 36 për të dytin²⁰. Gjithsesi, volumi i lëndëve të kulturës së përgjithshme nuk prekej. Gjuha shqipe tashmë përfshihej në programin e shkollës tetëvjeçare dhe gjuha e dytë e huaj bëhej fakultative. “Bazat e njohurive

¹⁹ *AQSH*, Fondi 511, viti 1962, dos. 20, fl. 4-5.

²⁰ *Po aty*, fl. 2-3.

politike” zëvendësonin lëndën e Kushtetutës. Por ndryshimet më të mëdha, ashtu si edhe për etapën e parë të arsimit të përgjithshëm kishin të bënin me mësimin e punës, i cili tashmë shkrihej brenda procesit mësimor.

Ideja fillestare ishte që puna në prodhim e nxënësve të zinte për afërsisht 31 për qind të totalit të orëve. Raportet më të mira midis lëndëve të kulturës së përgjithshme (3 461) me kulturën profesionale (1 512) parashikoheshin në variantin katërvjeçar. Më vonë pas zbatimit në shkollat eksperimentale, puna në prodhim zuri për afërsisht 16 për qind të programit mësimor²¹. Sipas të dy varianteve, lidhja e mësimit me praktikën do të realizohej nëpërmjet mësimit të punës në prodhim pranë një ndërmarrjeje industriale ose bujqësore. I gjithë sistemi synonte pajisjen e nxënësve me njohuri teknike të përgjithshme dhe njohuri fillestare në një specialitet masiv, pas përfundimit të shkollës së mesme.

Vëmendje e veçantë në këtë periudhë iu kushtua edhe punës për përgatitjen e teksteve të ndryshuara si bazë për funksionimin e rregullt të shkollave. Për këtë qëllim në vitin 1963, si pjesë e strukturës së Ministrisë së Arsimit, krijohet Drejtoria e Botimeve Arsimore²². Fillimisht u punua për korrigjimin e pjesëshëm të një pjese të teksteve të lëndëve bazë dhe më tej, me aprovimin e projekt-programeve të reja për shkollën 8-vjeçare, filloi hartimi i teksteve të reja. Në përputhje me kërkesat e shkollës së riorganizuar u hartuan tekstet e klasave I-V. Ato iu nënshtruan diskutimit të gjerë sidomos nga mësuesit e lëndëve. Ripunime të thella iu bënë edhe teksteve të shkollës së mesme. Meqenëse aplikimi i tyre në mënyrë masive do të realizohej më vonë se tekstet e shkollës 8-vjeçare, u panë më me qetësi dhe kujdes.

Dokumentacioni i ri shkollor u aplikua fillimisht në disa shkolla eksperimentale, numri i të cilave erdhi në rritje. Sipas një udhëzimi të Ministrisë së Arsimit ktheheshin në shkolla të tilla, shkolla e mesme e përgjithshme e Bilishtit, Kavajës, Lushnjës, Fierit, Shkolla “16 Shtatori” e Durrësit, “29 Nëntori” e Shkodrës, Shkollat “Çajupi”, “Qemal Stafa” dhe ajo e Kombinatit të tekstileve “Stalin” në Tiranë. Në to do të eksperimentohej zbatimi praktik i lidhjes të të mësuarit me punën prodhuese duke synuar, siç do të theksohej në të, fitimi i një eksperience

²¹ *Po aty*, Fondi 14, viti 1965, dos.1, fl.1-15.

²² *Po aty*, Fondi 511, viti 1961, dos.12, fl.31-32.

që do të ndihmonte në procesin e riorganizimit të shkollës²³. Shkollat eksperimentale e bazuan punën e tyre në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme dhe në programet e reja për mësimin teorik e praktik të prodhimit, që fillimisht ishin orientuese. Në këto shkolla synohej kombinimi i njohurive të përgjithshme me ato politeknike nëpërmjet zhvillimit teorikisht dhe praktikisht të mësimin të prodhimit, duke i përgatitur nxënësit me profesion të një specialiteti të profilit të gjerë. Ndërkohë ato do të angazhoheshin në zgjidhjen edhe të disa problemeve praktike si p.sh. në gjetjen e formave për alternimin e punës mendore me atë fizike në kushtet e çdo shkolle si dhe të kohës së nevojshme për përgatitjen profesionale në një specialitet të caktuar. Në përcaktimin e specialitetit, shkolla duhej të orientohej drejt atyre më masive, që nënkuptonte sa më shumë punëtorë të kualifikuar në industri, bujqësi apo ndërtim, duke bashkëpunuar gjithmonë me organet e arsimit dhe strukturat e tjera shtetërore. Mbi të gjitha ato duhej të punonin për përgatitjen “e nxënësve aktivë për ndërtimin e socializmit, me kulturë të gjerë, me kalitje ideologjike dhe edukatë pune”²⁴.

Gjatë zhvillimit të lëndëve teknike të përgjithshme u bë kujdes dhe iu dha përparësi punëve praktike e laboratorike. Eksperimentimi në klasat e fillores eci mirë. Fëmijët merrnin pjesë me kënaqësi në mësimin e punës së dorës duke fituar disa shprehje e shkathtësi. Por në to zhvillohej dobët puna bujqësore, vetëshërbimi dhe puna e dobishme shoqërore. Shumica e shkollave eksperimentale në qytete nuk kishin kopshte bujqësore. Problemi ishte më i ndërlikuar në klasat e larta të shkollës 8-vjeçare dhe në etapën e dytë të arsimit të përgjithshëm. Suksesi i eksperimentit kushtëzohej jo vetëm nga sigurimi i një baze të mirë materiale dhe vendosja e lidhjeve të ngushta me ndërmarrjet industriale apo bujqësore, por edhe me ndërgjegjësimin dhe aftësimin e personelit arsimor për të përballuar kërkesat e reja.

Gradualisht eksperimenti u zgjerua duke përfshirë 18 shkolla 11-vjeçare, nga të cilat 7 të profilit bujqësor, 12 shkolla 7-vjeçare në fshat, 40 shkolla fillore dhe të gjitha ushtrimoret e shkollave pedagogjike²⁵. Një pjesë e tyre ia arriti të krijojë një bazë deri diku të mjaftueshme materiale, duke pasuruar kabinetet e fizikës, kimisë, biologjisë dhe shtuar mjetet

²³ *Po aty*, viti 1960, dos.60, fl.17-18.

²⁴ *Po aty*, Fondi 511, viti 1960, dos.60, fl.18-19.

²⁵ *Po aty*, viti 1963, dos.3, fl.10-13.

mësimore në matematikë, gjeografi etj. U tentua dhe për vendosjen e lidhjeve me ndërmarrje të ndryshme, në mënyrë që këto të fundit të kontribuonin në pajisjen e dhomave të punës me mjete dhe, kthimin e tyre në punishte të thjeshta. Gjithsesi, në këtë fazë ende nuk bëhet fjalë për bashkëveprim të institucionalizuar e, për rrjedhojë, edhe për një angazhim të plotë të tyre, në sigurimin e lidhjeve të procesit mësimor me prodhimin. Rezultatet e para ishin të dobëta.

Siç u tha mbi bazën e tezave, zbatimi i reformës do të niste nga viti shkollor 1963-1964, fillimisht në klasat I-V dhe më tej do të shtrihej në klasat më të larta. Përvoja e proceseve të mëparshme kishte provuar se, gjatë zbatimit praktik dilnin probleme të vjetra apo të reja, por që gjithsesi duheshin përballuar për të garantuar suksesin. Para së gjithash, vëmendja do të vazhdonte të përqendrohej në sigurimin e kushteve për zgjerimin e mëtejshëm të arsimit, sidomos të atij tetëvjeçar që përbënte edhe kategorinë bazë të sistemit të ri. Kalimi në arsimin e detyrueshëm tetëvjeçar ishte gjithashtu një problem që kërkonte zgjidhje. Tërheqja e sa më shumë nxënësve, sidomos në klasat e larta, ishte një proces i vështirë që kërkonte një angazhim total si të strukturave arsimore, ashtu edhe të masës së mësuesve. Në shkallë vendi deri në vitin 1963 ishin tërhequr në arsimin shtatëvjeçar jo më tepër se 87,7 për qind e nxënësve që përfundonin filloren dhe rreth 75,7 për qind e nxënësve të fshatit. Ndërkohë kishte zona më të prapambetura, si: Puka, Rrethi i Tiranës, Rrësheni, Librazhdi, Kruja, Peshkopia, Tepelena etj., ku treguesit nuk i kalonin të 60 për qind²⁶. Rrjeti i institucioneve shkollore me gjithë përmirësimet e bëra në vite, mbetej i pamjaftueshëm. Lindte nevoja për investime të reja si për zgjerimin e tyre, ashtu edhe për plotësimin me bazën e duhur materiale.

I njëjti problem ishte edhe për arsimin e mesëm. Rritja e tij u konceptua si një proces i përshkallëzuar që fillimisht mund të zgjidhej duke tërhequr një numër gjithnjë e më të madh nxënësish në shkollat ekzistuese, si dhe duke shfrytëzuar më mirë kapacitetin e tyre. Meqenëse reforma do të shtrihej më vonë në këtë kategori arsimore, u mendua që shkollat e reja të hapeshin fillimisht në qendra të populluara dhe në ato zona ku arsimi shtatëvjeçar garantonte një kontigjent të mjaftueshëm nxënësish që e përfundonin atë.

²⁶ *Po aty*, fl.1-15.

Por çështja më e rëndësishme për gjithë procesin vazhdonte të mbetej ajo e personelit mësimor, e sigurimit të numrit të nevojshëm dhe çka ishte më e rëndësishme, me përgatitjen dhe predispozicionin e duhur për t'u bërë pjesë e reformës. Vëmendja e strukturave shtetërore në këtë fazë të rëndësishme të riorganizimit u fokusua në të dy drejtimet e njohura, të përgatitjes së mësuesve të rinj dhe në atë të kualifikimit të tyre. Nga viti 1960 deri në vitin 1963 u përgatitën përafërsisht 3 400 mësues në shkollat dhe institutet pedagogjike, si dhe në fakultetet e Universitetit. Në këto momente në arsim punonin rreth 18 172 veta dhe direkt në shkollë 14 493 mësues. Shtimi i personelit mësimor përbënte një faktor favorizues, por ende të pamjaftueshëm në kushtet kur kërkesat vinin në rritje. Përshpejtimi i ritmeve mbetej një sfidë e të ardhmes.

Po aq e mprehtë mbetej edhe çështja e përgatitjes së mësuesve me nivelin e nevojshëm profesional për të përballuar kërkesat e shkollës së riorganizuar. Me gjithë përpjekjet e bëra në vite për kualifikimin e personelit mësimor gjendja paraqitej problematike. Në arsimin fillor kishin arsimin përkatës vetëm 74,9 për qind e tyre, në atë shtatëvjeçar 32,3 për qind dhe në shkollën e mesme 61,9 për qind²⁷. Në këto kushte u tentua për të bërë përmirësime në burimin e përgatitjes së tyre. Ende në këtë fazë dominonte koncepti sipas të cilit nga shkollat pedagogjike apo institutet 2-vjeçare kërkohej kontigjent nxënësish për shkollat e larta, kur destinacioni kryesor i tyre duhej të ishte përgatitja e mësuesve për hallkat e ndryshme arsimore. Për t'i paraprirë përkeqësimit të problemit në të ardhmen, strukturat arsimore i kushtuan më tepër vëmendje mbarëvajtjes të kësaj kategorie shkollash, duke ndërmarrë edhe masa praktike. Gjatë periudhës përgatitore të reformës u bënë ndryshime të rëndësishme në planet dhe programet e tyre mësimore, me pikësynim forcimin e përgatitjes teorike dhe veçanërisht formimin e shprehive të nevojshme profesionale. Ndërkohë edhe në fakultetet e Universitetit që përgatisnin mësues, u punua më mirë për zhvillimin nga studentët të praktikave pedagogjike pranë shkollave.

Në këtë kuadër u bënë përpjekje për përsosjen e sistemit ekzistues të kualifikimit ku u përfshinë një pjesë e mirë e mësuesve, sidomos ata të kategorive më të larta shkollë. Nëpërmjet formave specifike u synua njohja më e mirë me kërkesat e programeve të reja, si dhe të metodave më efikase që do të garantonin rezultate pozitive gjatë zbatimit në

²⁷ *Po aty*, Fondi 14, viti 1964, dos.19, fl.1.

praktikën e shkollës. Kurse perfeksionimi vijuan të hapen në qytete e qendra të ndryshme të vendit, u organizuan seminare me drejtues të arsimit dhe me mësues të thjeshtë. Njohja me problemet më kryesore të riorganizimit dhe përballimi i tyre shënoi fillimin e një procesi sistematik që vijoi në vitet e mëvonshme dhe që kontribuoi pozitivisht në ecurinë e reformës.

Periodha trevjeçare shërbeu ndërkohë edhe për përgatitjen përfundimtare të kuadrit ligjor. Në qershorin e vitit 1963, Kuvendi Popullor i Shqipërisë dekretoi dy nga dokumentet më të rëndësishëm në fushën e shkollës, ligjin “Mbi riorganizimin e sistemit arsimor në RPSH” dhe dekretin “Mbi arsimin tetëvjeçar të detyruar”²⁸. Dispozitat kryesore të ligjit mbi riorganizimin rikonfirmonin të drejtat e mëparshme të bazuara në kushtetutën e vendit, si: arsimin falas, karakterin shtetëror, barazinë e sekseve etj. Ndërkohë sistemi i ri arsimor, me dhe pa shkëputje nga puna, që i përfshinte të gjitha kategoritë bazë, si: edukimin parashkollor, arsimin e përgjithshëm, etapa e parë e të cilit bëhej tetëvjeçare, arsimin tekniko-profesional dhe atë të lartë (neni 2), përsosej dhe plotësohej në linjat e tij themelore. Element i përbashkët i të gjitha hallkave të sistemit të ri shkollor ishin ndryshimet në bazën e tij. Ashtu siç evidencohet në tezat dhe si u eksperimentua deri në aprovimin e ligjit, zhvillimet më të mëdha i takonin shkollës së arsimit të përgjithshëm. Shkolla tetëvjeçare, karakteri i së cilës u rregullua me një ligj të veçantë si dhe përcaktohej në nenin 9, kishte si funksion t’u jepte “nxënësve njohuri të kulturës së përgjithshme dhe politeknike, të edukojë dashurinë për punën dhe të përgatiste nxënësit për punë të dobishme shoqërore”. I gjithë thelbi i ndryshimeve konsistonte në organizimin e një sistemi të ri që garantonte zbatimin e parimit të lidhjes të “të mësuarit dhe edukimit me jetën me prodhimin” (neni 4).

Me daljen e ligjit, reforma futet në fazën e zbatimit duke rrokur gjithë vitet 60. Efektet e saj ishin të rëndësishme dhe sollën zhvillime të reja si në strukturën e shkollës ashtu edhe në përmbajtjen e saj. Zbatimi në praktikën e këtij procesi, pavarësisht nga çfarë thuhej dhe pranohej, ishte i vështirë dhe përfaqësonte realisht një nga sfidat më të rëndësishme të kohës në këtë fushë. Pikësynimi i reformës ishte gjithnjë zbatimi i parimit marksist-leninist të lidhjes së të mësuarit me punën në prodhim, si një mjet i fuqishëm për edukimin komunist të gjeneratave të reja. Në

²⁸ “Gazeta zyrtare”, viti 1963, nr.9, f.161. Ligji nr.3697, dt 11.06.1963.

këtë kuptim ajo mbeti pjesë e strategjisë dhe e politikës së partisë-shtet për vendosjen gjithnjë e më të mirë të arsimit shqiptar në funksion të kërkesave të ekonomisë së centralizuar. Nëpërmjet kësaj reforme, ajo synonte kthimin sa më të shpejtë të shkollës në institucionin më të specializuar për përgatitjen e burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe sidomos të përshtatshme për një shoqëri socialiste në konsolidim. Në ndërtimin e politikave arsimore iu përmbajt parimeve të përgjithshme që mbetën të pandryshuara, duke vazhduar të bazohej gjithnjë në eksperiencën e shkollës sovjetike, madje edhe pas prishjes me Bashkimin Sovjetik. Reforma hapi rrugën e përsosjes së sistemit shkollor duke tentuar ta bëjë atë më masiv dhe më fleksibël, por ndërkohë shërbeu si një mekanizëm i rëndësishëm për ideologjizimin dhe kthimin në vatër indoktrinimi me ideologjinë komunistë, duke kontribuar gjithnjë e më tepër në konsolidimin e një shkolle thellësisht të orientuar.

S u m m a r y

THE BEGINNINGS OF EDUCATIONAL SYSTEM'S REORGANIZATION (1960-1963)

The 60s marked the entrance of the Albanian school in a new period during which were initiated a number of changes that are known as "The reorganization of the educational system". Their essence consisted in the perfection of the existing education system based on the principle of the bounding of the teaching with the work on the production and especially in the establishing of the school in the function of the party-state for the development of the socialist economy and culture. The reorganization was attained as a process commanded and controlled from the high authorities, gradual and step by step.

The period from the beginning of 1960 to June of 1963 when it was completed the preparation for the full legislative setting it served as preparatory phase to continue on with practical implementation of the reform in the academic year 1963-64. The platform of changes was prepared in form of theses that were made public in the June 22nd 1960. They delineated the fundamental lines which were focused in the school of general education divided in two stages. *The first stage*, the term of which was extended from 7 to 8 years represented the basis of the new educational system and as such it took a unique and obligatory character.

The second stage, with a debatable duration 3 or 4 years would have given to the youth a full high school education.

With the publication of the thesis the phase of debates started for the introduction of the public opinion and of the specialists with the expected amendments. The three year period it served in the meantime for the final preparation of the legislative body. In June of 1963, the Peoples' Assemble of Albania it decreed the law "On the reorganization of the educational system in Peoples' Republic of Albania" and the decree "*On the obligatory eight year education*".

Then the reform entered the phase of practical implementation. This was part of the strategy and the policy of the party-state in establishing the Albanian education in the function of the needs of the centralized economy. The reform opened the door to perfection of the educational system aiming to make it massive and more flexible, but in the meantime it served as an important mechanism for the ideology and turning the school in a nest of indoctrination of the young generations with the communist ideology by contributing increasingly in its consolidation as deeply oriented school.